UNIVERSITETI I PRISHTINËS

Nr. Prot:_____________

Datë: ____/____/_____

UNIVERSITETI I PRISHTINËS "HASAN PRISHTINA"
FAKULTETI I EDUKIMIT
PRISHTINË
Pranuar me: 24.06.2026
Nj. org. | Numër | Shtojca | Vlera
04 | 1597 | - | —

# RAPORT I KOMISIONIT VLERËSUES
# PËR ANGAZHIMIN E BASHKËPUNËTORËVE TË JASHTËM (*ad junct*)

| | |
|---|---|
| Fakulteti: | i Edukimit |
| Pozita e shpallur në thirrje: | **Pozita 3.**<br>Të konkursit me numër protokoli 1/746 të datës: 29/05/2026 |
| Lëndët: | Shkencat e natyrës në fëmijëri të hershme (BA, EFH),<br>Shkencat e natyrës me metodologji (BA, Fillor) |
| | (*shto radhë nëse duhet*) |
| Kandidatët e paraqitur: | 1. Rinesa Gashi<br>2. Valmir Shala<br>3. Latif Hasi<br>4. Florentina Hamidi Sadiku<br>5. Addhe Krasniqi<br>6. Leonora Çarkaj Shabani<br>7. Aulona Sopjani<br>8. Fatbardha Maçastena<br>9. Selvete Sylejmani<br>10. Merita Sejdiu<br>11. Diamanta Zogjani<br>12. Blerta Mehmetaj<br>13. Ardiana Lahu<br>14. Ilir Jusufi |

*(shto radhë nëse duhet)*

Nr. prot. --------------, Dt. ------------------

Thirrja për angazhim: Bashkëpunëtor i jashtëm për ushtrime

Komisioni vlerësues:

| | |
|---|---|
| **1. Kryetar** | Prof. Asoc. Zeqir Veselaj |
| **2. Anëtar** | Prof. Asoc. Arlinda Bytyqi- Damoni |
| **3. Anëtar** | Prof. Asst. Vjollca Ahmedi |
| 4. Anëtar | Prof. |
| 5. Anëtar | Prof. |

| Nr. | Emri dhe mbiemri | Grada shkencore | Aplikohet për bashkëpunëtorët e jashtëm për ligjërata | | | Aplikohet për bashkëpunëtorët e jashtëm për ushtrime | | | Mosha (datëlindja) | Përvoja e punës në fushën përkatëse (vitet) | Bie ndesh me Rregulloren nr. 2/254, dt. 17.07.2024, për procedurat vlerësuese për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm në UP (PO/JO) | Propozohet të angazhohet (PO/JO) |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Thirrja akademike | Publikimet në revista shkencore ndërkombëtare, në përputhje me Rregulloren nr. 2/254, dt. 17.07.2024, për procedurat vlerësuese për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm në UP | Përvoja e punës profesionale në mjekësinë terciare (Fakulteti i Mjekësisë) | Nota Ba. | Nota Ma. | Specializimi për lëndët klinike në Fakultetin e | | | | |
| 1. | Rinesa Gashi | Msc | / | 0 | / | / | / | | 2002 | 0 | | JO |
| 2. | Valmir Shala | Bsc | | 0 | | 8.03 | / | | 1995 | 0 | PO | JO |
| 3. | Latif Hasi | Msc | | 2 | | 8.27 | 9.11 | | 1999 | 1 vit | | JO |
| 4. | Florentina Hamidi Sadiku | Msc | | 0 | | 7.93 | 7.15 | | 1986 | 0 | PO | JO |
| 5. | Addhe Krasniqi | Msc | / | 0 | | 8.61 | 9.71 | | 1989 | 0 | | JO |
| 6. | Leonora Çarkaj Shabani | PhD | | 0 | | 8.25 | 8.25 | | 1989 | 9 vite | | JO |
| 7. | Aulona Sopjani | Msc | | 0 | | 8.61 | 9.00 | | 1998 | 0 | | PO |
| 8. | Fatbardha Maçastena | Msc | | 0 | | 9.18 | 9.64 | | 1998 | 0 | | JO |

| | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 9. | Selvete Sylejmani | Msc | | 0 | | 8.71 | 8.67 | | 1977 | 0.5 vite | | JO |
| 10. | Merita Sejdiu | Msc | | 0 | | 9.05 | 9.40 | | 1996 | 0 vite | | JO |
| 11. | Diamanta Zogjani | Msc | | 0 | | 9.26 | 9.07 | | 1999 | 0 vite | | JO |
| 12. | Blerta Mehmetaj | Msc | | 0 | | 8.83 | 9.18 | | 1996 | 0 vite | | JO |
| 13. | Ardiana Lahu | Msc | | 0 | | 8.07 | 8.80 | | 1997 | 0 vite | | JO |
| 14. | Ilir Jusufi | Msc | | 0 | | 8.9 | 9.06 | | 1998 | 0 vite | | JO |

## RAPORTI PËRMBLEDHËS I KOMISIONIT VLERËSUES

(Ky *raport duhet të përmbajë përshkrimin e përmbledhur dhe emrin e secilit kandidat të paraqitur në pozitën/lëndët përkatëse, dhe arsyetimin e veçantë për kandidatin/ët që propozohet/n për angazhim si bashkëpunëtor/ë i/të jashtëm*).

**1. Rinesa Gashi:** Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit të dorëzuar, është konstatuar se në sistem nuk figurojnë dëshmitë dhe dokumentacioni i nevojshëm për verifikimin e përmbushjes së kritereve të konkursit. Për shkak të mungesës së dokumentacionit mbështetës, komisioni nuk ka arritë të bëjë vlerësimin e aplikimit.

**2. Valmir Shala:** Kandidati nuk i plotëson kërkesat formale të konkursit si dhe formimi i tij akademik Ekonomi- Menaxhim nuk korrespondojnë me profilin e kërkuar në konkurs.

**3. Latif Hasi:** Kandidati posedon bachelor dhe master shkencor në fizikë. Njëherit është kandidat i doktoratës në Institute of Earthquake Engineering and Engineering Seismology dhe i ka dy punime të publikuara në fushën e tij të studimit. Megjithëse i plotëson kushtet formale të konkursit nuk evidentohet një formim akademik ose profesional në fushën e edukimit, element i rëndësishëm për pozitën e shpallur.

**4. Florentina Hamidi Sadiku:** Kandidatja ka përgatitje akademike në fushën e fizikës, mirëpo nuk i plotëson kriteret e përcaktuara në rregullore lidhur me notën mesatare të studimeve, e cila përbën kusht të domosdoshëm për shqyrtimin e mëtejmë të aplikimit.

**5. Addhe Krasniqi:** Formimi akademik bachelor i kandidatit është në fushën e gjeografisë me master në gjeografi shkencore dhe udhëheqje në arsim. Megjithëse i plotëson kushtet formale të konkursit, fusha e studimit nuk përputhet me kërkesat specifike të konkursit dhe me profilin akademik të kërkuar.

**6. Leonora Çarkaj Shabani:** Kandidatja ka përfunduar studimet bachelor në biologji arsimore dhe studimet master në biologji. Ka doktoraturë në Menaxhim Mjedisor dhe është e angazhuar si asistente e rregullt në Universitetin e Mitrovicës. Duke qenë se studimet e

doktoratës janë të orientuara në menaxhim mjedisor dhe jo në fushën e edukimit ose disiplinat specifike të kërkuara nga konkursi, kandidatura konsiderohet jashtë profilit të kërkuar.

**7. Aulona Sopjani:** Kandidatja posedon diplomë bachelor në kimi dhe diplomë master në mësimdhënien lëndore me specializim në kimi. Eshtë kandidate për doktoratë në program të dyfishtë (double degree) në mes të Fakultetit të Edukimit dhe Universitetit të Ljublanës, në drejtimin: Mësimdhënia dhe të nxënit e shkencave të natyrës. Kandidatja i plotëson kushtet formale të konkursit si dhe fusha e studimit përputhet me kërkesat specifike të konkursit dhe me profilin akademik të kërkuar.

**8. Fatbardha Maçastena:** Kandidatja ka përfunduar studimet bachelor në prgramin Fillor dhe studimet master në Mësimdhënie dhe Kurrikulë. Posedon përgatitje pedagogjike, por formimi i saj nuk lidhet drejtpërdrejt me disiplinat shkencore të kërkuara nga konkursi.

**9. Selvete Sylejmani:** Kandidatja ka përfunduar studimet bachelor në Fizikë-Kimi dhe studimet master me 60 kredi në të njëjtën fushë. Ka përvojë të kufizuar akademike, duke qenë e angazhuar për një periudhë prej rreth gjashtë muajsh në Universitetin e Gjilanit.

**10. Merita Sejdiu:** Kandidatja ka përfunduar studimet master në Edukim Inkluziv. Profili akademik nuk lidhet drejtpërdrejt me fushat dhe lëndët specifike të kërkuara nga konkursi.

**11. Diamanta Zogjani:** Kandidatja ka përfunduar studimet bachelor në Pedagogji të Përgjithshme dhe studimet pasuniversitare në të njëjtën fushë. Formimi akademik i saj konsiderohet jashtë profilit disiplinor të kërkuar për pozitën.

**12. Blerta Mehmetaj:** Kandidatja ka përfunduar studimet bachelor në Programin Fillor dhe studimet master në Mësimdhënie dhe Kurrikulë. Ka paraqitur dëshmi për statusin e kandidatit të doktoratës në Maqedoni, mirëpo dokumenti i dorëzuar nuk është i përkthyer dhe as i noterizuar, duke e bërë të pamundur verifikimin formal të këtij kualifikimi. Posedon përgatitje pedagogjike, por formimi i saj nuk lidhet drejtpërdrejt me disiplinat shkencore të kërkuara në konkurs.

**13. Ardiana Lahu:** Kandidatja ka përfunduar studimet bachelor në Edukimin Parashkollor dhe studimet master në Pedagogji. Formimi akademik nuk korrespondon me profilin disiplinor të kërkuar në konkurs.

**14. Ilir Jusufi:** Kandidati posedon diplomë Bachelor në Fizikë dhe diplomë Master në Shkencat e Fizikës. Nuk evidentohet një profil i theksuar në fushën e edukimit ose i integruar me kërkesat specifike pedagogjike të pozitës.

**Përfundim**

Pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe analizimit të përputhshmërisë së kandidatëve me kriteret e konkursit, konstatohet se dy prej kandidatëve me numër rendor 1 dhe 2 nuk i plotësojnë kushtet formale, ndërsa kandidatët prej numrit rendor 3 deri në 14, përjashtimit kandidates me numër rendor 7, kanë formim akademik që nuk korrespondon me profilin e kërkuar.

Nga kandidatët që i plotësojnë kriteret themelore për shqyrtim, **Aulona Sopjani** dallohet për nivelin më të lartë të përputhshmërisë me profilin e kërkuar. Formimi i saj akademik përfshin studimet bachelor në Kimi, studimet master në Edukim, si dhe angazhimin aktual në studimet e doktoratës në program e dyfsihtë ndërkombëtar (double degree Universiteti i Ljubljanës dhe Universiteti i Prishtinës) në fushën e edukimit – drejtimi Mësimdhënia dhe të nxënit e shkencave të natyrës. Ky profil akademik paraqet një integrim të qëndrueshëm ndërmjet ekspertizës disiplinore në shkencat natyrore dhe kompetencave pedagogjike, duke reflektuar drejtpërdrejt me kërkesat e pozitës së shpallur. Në krahasim me kandidatët e tjerë, kandidatja demonstron një vazhdimësi më të qartë të zhvillimit akademik dhe profesional në fushat që ndërlidhen me edukimin dhe mësimdhënien e shkencave, duke ofruar potencial të lartë për kontribut në procesin e mësimdhënies, zhvillimin akademik dhe veprimtarinë kërkimore-shkencore.

Si përfundim, komisioni i propozon Këshillit të Fakultetit të Edukimit që kandidaten **Aulona Sopjani** ta zgjedhë në pozitën e bashkëpunëtores së jashtme për ushtrime për lëndët e paraqitura në konkurs.